



SHOQËRIA

PËR KLASËN E DYTË

GLIKERIA ILIOSKA



SHOQËRIA PËR KLASËN E DYTË

Glikeria Ilioska

Shoqëria për klasën e dytë

Autore:

Glikeria Ilioska

Recensentë:

Marieta Petrova
Svetllana Josifoska
Vesna Nedanovska

Ilustrimet:

Elizabeta Angelova Shurbevski

Botues:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Titulli i original:

Општество за второ одделение
Гликерија Илиоска

Redaktor: Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Refail Sulejmani

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Solidar Sulejmani

Lektor: Refail Sulejmani

Rregullimi grafik dhe teknik: Magdalena Avramovska, Evgenija Pavlova – ARS STUDIO

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Shoqëria për klasën e dytë nr. 26-1660/1 të datës 07.12.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:316.3(075.2)=18

ILIOSKA, Glikeria

Shoqëria për klasën e dytë [Електронски извор] / Glikeria Ilioska ; [Ilustrimet Elizabeta Angelova Shurbevski ; përkthyer nga gjuha maqedonase Refail Sulejmani]. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2023

Начин на пристапување (URL):

https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Opstestvo_2_alb.pdf. - Превод на делото: Општество за второ одделение / Гликерија Илиоска. - Текст во PDF формат, содржи 98, [2] стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. -
Опис на изворот на ден 30.01.2023

ISBN 978-608-273-358-6

COBISS.MK-ID 59254021

SI TA PËRDORËSH LIBRIN MËSIMOR



SIMBOLET QË DO T'I HASËSH NË KËTË LIBËR MËSIMOR



MENDO DHE PËRGJIGJU

Pyetje dhe aktivitete që do të të inkurajojnë në të menduarit dhe në përvetësimin më të lehtë të përmbajtjes.



DETYRË

Detyrat që duhet t'i përgjigjesh



AKTIVIZOHU:

Aktivitete për kërkime, diskutime, debate dhe krijimin e projekteve që do ta bëjnë mësimin tënd më interesant.

Teksti që të ndihmon të kuptosh përmbajtjen e mësimi.



PËRMBAJTJA

TEMA 1: NË SHKOLLË	5
TË PUNËSUARIT NË SHKOLLË	8
ORGANIZIMI HAPËSINOR NË SHKOLLË	11
HAPËSIRAT NË SHKOLLËN TONË	11
RRUGA NGA KLASA JONË NË HAPËSIRAT E TJERA	15
BASHKËSIA E KLASËS	18
UDHËHEQJA E BASHKËSISË SË KLASËS	18
BASHKËSIA E KLASËS I PËRFAQËSON INTERESAT A MIA	21
MARRIM VENDIME SI GRUP	23
CILËSITË E DËSHIRUESHME TË NXËNËSVE	25
SI TË ARRINI SUKSES?	25
BASHKËPUNOJ ME SHOKËT	29
SJELLJA NË SHKOLLË	31
SI KOMUNIKOJ?	31
SI SILLEM?	34
E RESPEKTOJ MENDIMIN E TË TJERËVE	36
TË GJITHË JEMI TË BARABARTË - DJEM DHE VAJZA	38
TË GJITHË JEMI TË BARABARTË - GJUHA NUK ËSHTË PENGESË PËR MIQËSI.....	40
TË GJITHË JEMI TË BARABARTË - MËSOJMË SË BASHKU	42
 TEMA 2: NË SHTËPI	 45
FAMILJA MË E GJERË DHE FESTIMET FAMILJARE	48
FAMILJA IME MË E GJERË	48
FAMILJA IME FESTON	51
SIPËRGATITEMI PËR FESTË.....	55
HAPËSIRAT, MOBILJET DHE APARATET NË SHTËPI	58
HAPËSIRAT DHE MOBILJET NË SHTËPINË TIME.....	58
APARATET NË SHTËPI DHE PËRDORIMI I SIGURT I TYRE	60
CILËSITË E DËSHIRUARA TË FËMIJËVE NËSHTËPI/FAMIJE	63
MBROJTJA NGA FATKEQËSITË ELEMENTARE	67
ZJARR.....	67
PËRMBYTJA.....	69
TËRMETI.....	71
 TEMA 3: VENDBANIMI	 73
VENDBANIMI	76
QYTETI/FSHATI	76
OBJEKTET NË QYTET	79
JETA NË FSHAT DHE JETA NË QYTET	81
NGA ARA NË TRYEZË.....	81
FSHAT APO QYTET?	85
TRAFIKU NË VENDBANIM.....	87
UNË SI KËMBËSOR	87
UNË SI ÇIKLIST	91
SI SILLEM NË AUTOBUS	95

TEMA 1: NË SHKOLLË



TEMA 1: NË SHKOLLË

✓ TË PUNËSUARIT NË SHKOLLË

✓ ORGANIZIMI HAPËSINOR I SHKOLLËS TONË:

- Hapësirat në shkollën tonë
- Rruga nga klasa jonë deri në hapësirat e tjera

✓ BASHKËSIA E KLASËS:

- Udhëheqja e bashkësisë së klasës
- Bashkësia e klasës i përfaqëson interesat e mia
- Rregullat për marrjen e vendimeve në grup

✓ CILËSITË E DËSHIRUESHME TË NXËNËSVE:

- Si të arrini sukses?
- Bashkëpunoj me shokët

✓ SJELLJA NË SHKOLLË:

- Si komunikoj?
- Si sillem?
- E respektoj mendimin e të tjerëve
- Të gjithë jemi të barabartë – djem dhe vajza
- Të gjithë jemi të barabartë – gjuha nuk është pengesë për miqësi
- Të gjithë jemi të barabartë – mësojmë së bashku






TË PUNËSUARIT NË SHKOLLË


KUJTOHU:

Si quhen arsimtarët e tu?
Si janë emrat e të punësuarve të tjerë në shkollën tënde?
Cilat janë profesionet e tyre?




MENDO DHE PËRGJIGJU

- Kush e organizon punën e gjithë shkollës?
- Kush kujdeset për higjienën në shkollë dhe në oborr?
- Kujt do t'i drejtohesh nëse dëshiron të huazosh një libër nga biblioteka e shkollës?



Drejtori/drejtoresha

E organizon punën e gjithë shkollës.




Pedagogu

Ndihmon që nxënësit ta përmirësojnë mësimin.



Psikologu

Ndihmon të kuptosh dhe të përmirësosh sjelljen tënde.



Sekretari/sekretaresha

I ndihmon drejtorit në punën e tij.



Bibliotekisti/ bibliotekistja

U jep libra nxënësve dhe punonjësve të shkollës.



Defektologu

I ndihmon nxënësit me mundësi të zvogëluara që të mësojnë më lehtë dhe të përshtaten në jetën shkollë.



Logopedi

U ndihmon nxënësve që kanë vështirësi në të folur dhe dëgjim.



Higjienisti/higjienistja

Kujdeset për higjienën në shkollë dhe në oborrin e shkollës.



Punëtori/punëtorja sociale

U jep mbështetje dhe këshilla nxënësve në jetën shkollore dhe u ndihmon të zgjidhin problemet që hasin.

Në shkollë janë të punësuar njerëz që kujdesen për arsimimin, edukimin, mbrojtjen, sigurinë dhe zhvillimin e duhur. Bëhet fjalë për persona me profesione të ndryshme: drejtor, pedagog, psikolog, punonjës social, defektolog, bibliotekist, higjienist. Pedagogu, psikologu, defektologu dhe punonjësi social janë bashkëpunëtorë profesionistë që kujdesen bashkërisht për zhvillimin tënd si person.



MENDO DHE PËRGJIGU

- Ku duhet të shkosh nëse një shok klase të ofendon?
- Ku duhet të shkosh nëse ke vështirësi në të mësuar?
- Kush i ndihmon nxënësit që kanë mundësi të zvogëluara?
- Cila është detyra e drejtorit të shkollës?
- Cila është detyra e logopedit?
- Çfarë mjetesh pune i nevojiten higjienistit?



AKTIVIZOHU:

Nëse dëshiron të mësosh më shumë rreth punës së një punonjësi të shkollës, drejtoju atyre me pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë punon?
- Ku është vendi i tij i punës?
- Cila mjete pune i nevojiten?
- A i pëlqen puna e tij?


Përgjigjet shkruaji dhe më pas diskuto për profesionet e tjera të punonjësve të shkollës.

ORGANIZIMI HAPËSINOR I SHKOLLËS TONË

HAPËSIRAT NË SHKOLLËN TONË

KUJTOHU:

Si është emri i shkollës sate?
Në cilën klasë mëson?
Si quhet hapësira ku mëson?
Numëroji dhe përshkruaji hapësirat e shkollës që i ke përdorur.
Cilat janë rregullat e sjelljes në hapësirat e shkollës?



MENDO DHE PËRGJIGU

- Si quhet hapësira në të cilën huazon libra?
- Ku duhet të shkosh nëse dëshiron të marrësh këshilla nga psikologu i shkollës?
- Për çfarë shërben salla sportive?



Klasa


Vend ku mëson dhe shoqërohesh me shokët e tu.



Kabineti


Hapësirë e cila përdoret për mësimin e disa lëndëve mësimore si shkencat natyrore, biologjia, kimia, informatika, matematika, gjuha e huaj.






Zyrat

Hapësirë ku punon drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionistë.



Zyra e arsimtarëve

Hapësirë për arsimtarë në të cilën mbahen edhe mbledhje.




Biblioteka e shkollës

Hapësirë ku mbahen, lexohen dhe huazohen librat.




Salla sportive

Hapësirë ku nxënësit kryejnë ushtrime fizike dhe stërviten ekipet dhe klubet sportive.



Tualeti

Hapësirë ku ruhet higjiena personale.



Kuzhina dhe tryeza

Hapësirë e cila shërben për përgatitjen e ushqimit dhe ushqyerjen e organizuar të nxënësve.



Oborri i shkollës

Vend i cili është jashtë ndërtesës së shkollës. Në të shoqërohesh me shokët e tu gjatë pushimeve. Në disa oborre të shkollave ka fusha sportive.

- Në shkollë ka **hapësira** të ndryshme: klasa, zyra, biblioteka, kuzhina dhe tryeza, tualete, salla sportive, oborri i shkollës. Secila prej këtyre hapësirave ka **qëllimin** e vet. Sa herë që i përdor hapësirat e shkollës, duhet t'i kushtosh vëmendje higjienës dhe t'u përmbahesh rregullave për sjellje të përgjegjshme në to.



MENDO DHE PËRGJIGU

- Cilat nga hapësirat e mëposhtme janë në shkollën tënde? Shto nëse ka hapësirë në shkollën tënde që nuk është përmendur më sipër. Përkthyer se për çfarë përdoret ajo hapësirë dhe si duket.
- Bëj krahasim në pamjen e klasës sate dhe kabinetit për shkencat natyrore. Cilat janë ndryshimet dhe cilat janë ngjashmëritë?
- Çfarë hapësira do të dëshirosh të kishe në shkollën tënde? Cili do të ishte qëllimi i tyre?
- Përkthyer dhe shpjego si duhet të sillesh në hapësirat e shkollës?



DETYRË

Në hapësirën e zbrazët vizato si do të duket hapësira që dëshiron ta kesh në shkollën tënde dhe shpjego për çfarë do të shërbente dhe me çfarë do të pajiset.





DETYRË



Lexoji thëniet, mendo dhe plotëso vendet e zbrazëta (zgjidh nga banka e ofruar e fjalëve):

Jane dëshiron të lexojë librin "Zoki Poki". Ai duhet të shkojë në _____ për të huazuar një libër.

Maria dhe Valmira luajnë basketboll. Ato gjenden në _____.

Arsimtarja i njoftoi nxënësit se do të bëjnë eksperiment për të ushqyerit e bimëve dhe se atë do ta bëjnë në _____.

Jovana ka nevojë për vërtetim se është nxënëse e rregullt. Atë do t'ia japë sekretaresha. Jovana duhet të shkojë te _____.

BANKA E FJALËVE:

zyra

klasa

biblioteka

tualeti

kabineti nga shkencat

salla sportive

zyra e arsimtarëve



AKTIVIZOHU:



Së bashku me shokët e klasës sate bëni foto album me hapësirat në shkollën tuaj. Nën çdo fotografi përshkruaj se kush punon dhe qëndron në to, pamjen dhe qëllimin e tyre. Në fund secili prej jush le të shkruajë në cilën hapësirë dëshiron të qëndrojë më shumë.

RRUGA NGA KLASA JONË DERI NË HAPËSIRAT E TJERA

KUJTOHU:

Cila hapësirë ndodhet:

- në të majtë të klasës sate
- në të djathtë të klasës sate dhe
- përballë klasës sate?

Si duhet të sillësh gjatë lëvizjes nëpër korridor dhe shkallët e shkollës?



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Shiko ilustrimin dhe përshkruaje rrugën që duhet bërë nga klasa në sallën e sportit:





MENDO DHE PËRGJIGJU

Përshkruaje rrugën nga klasa jote deri te:

- biblioteka
- zyra e bashkëpunëtorit profesional
- tualetet
- tryeza.

(Në të njëjtën kohë përdori shprehjet: majtas, djathtas, përpara, prapa, lart, poshtë, rreth).

- Pse është e nevojshme të dihet se ku dhe si të lëvizësh në shkollë?



- Për ta bërë më të lehtë gjetjen e rrugës nëpër shkollë, duhet të dish
- **rrugën për në hapësirë të caktuar.** Në të njëjtën kohë duhet t'u
- përmbahesh rregullave të sjelljes në shkollë: mos vrapo ose mos u
- shty me shokët nëpër shkallë dhe korridor. Kujdesu për higjienën.
- Gjithmonë ndihmoji shokut që nuk e di se ku është ndonjë hapësirë.
- Përhëndeti të punësuarit derisa lëvizni nëpër shkollë dhe oborr të shkollës.



DETYRË

Shoku juaj më i vogël humbi në korridorin e shkollës. Dëshiron të shkojë në tualet. Çfarë do të bësh? Përshkruaje rrugën që duhet ta kaloni.

.....

.....

.....


.....

.....

.....



BETYRË



Në fushën e zbrazët vizato rrugën tënde nga klasa deri në oborrin e shkollës. (Ndihtë: fillimisht vizato klasën tënde në formën e një katrori ose ndonjë simboli tjetër. Më pas vizato atë që është në të majtë të saj, në të djathtë të saj dhe përballë saj. Mendo se në cilin drejtim nga korridori i shkollës duhet të lëvizësh. Duke përdorur shigjeta, vizato rrugën nga klasa jote deri në oborrin e shkollës. Mos harro në vizatim ta shënosh edhe derën e hyrjes së shkollës).



BASHKËSIA E KLASËS

UDHËHEQJA E BASHKËSISË SË KLASËS



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilat aktivitete i kryeni në klasë/paralele?
- Kur ndihesh më mirë: kur punon vetëm ose së bashku me shokët e tu?
- Cili nga klasa jote të ndihmon kur has në ndonjë problem?
- Përshkruaj një situatë kur së bashku me shokët e klasës ke zgjidhur ndonjë problem. Si u ndjeve atëherë?
- A e di se çfarë është bashkësia e klasës?




- **Bashkësia e klasës** përbëhet nga të gjithë nxënësit e klasës. Në të vendoset për çështje që kanë të bëjnë me mësimin, qëndrimin në shkollë, marrëdhëniet e ndërsjella dhe marrëdhëniet me të rriturit e shkollës. Çdo bashkësi e klasës zgjedh **kryetarin, nënkryetarin** dhe **anëtarët e trupave të përhershëm**. Në bashkësinë e klasës sipas nevojës formohen **trupa të përkohshëm**. Kryetari zgjidhet me votë të fshehtë. Nxënësit anëtarësohen në trupat e përhershëm dhe të përkohshëm vullnetarisht dhe sipas interesave të tyre.

ROLI I KRYETARIT, TRUPAVE TË PËRHERSHËM DHE TË PËRKOHSHËM.



Kryetar i bashkësisë së klasës	Trupat e përhershëm	Trupat e përkohshëm
- perfaqeson klasën e tij në parlamentin e nxënësve - organizon zgjidhjen e problemeve në klasë - kujdeset për zgjidhje të qetë të mosmarrëveshjeve ndërmjet shokëve në klasë/ paralele - merr pjesë në mbledhjet prindërore - informon nxënësit e klasës/ paraleles për çështjet që vendosen në parlamentin e nxënësve – organizon formimin e trupave të përkohshëm.	Marrin pjesë në planifikimin dhe organizimin e: - festimeve dhe manifestimeve - ekskursioneve - aksioneve ekologjike - aktiviteteve humanitare - sportit.	Formohen sipas nevojës për çështje të ndryshme (për shembull: veshja e uniformave, krijimi i tabelës, ndihma e nxënësit në mësim, zgjidhja e problemeve etj.).



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Kush e përbën bashkësinë e klasës?
- Çfarë cilësish duhet të posedojë kryetari i bashkësisë së klasës?
- Si duhet të sillet kryetari ndaj shokëve të tjerë të klasës?



DETYRË

Ndoshta dëshiron të jesh kryetar i bashkësisë së klasës. Në mënyrë që shokët e tu të të zgjedhin, ti duhet t'u shpjegosh atyre pse duhet të të zgjedhin. Këtë do ta bësh nëse u përgjigjesh pyetjeve të mëposhtme

1. Çfarë do të bësh për klasën tënde nëse do të ishe kryetar i bashkësisë së klasës?
2. Si do të silllesh me shokët dhe shoqet e klasës nëse do të ishe kryetar i bashkësisë së klasës?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve shkruaji dhe më pas lexoji para shokëve të tu.




AKTIVIZOHU:

Në klasë/paralele organizoni zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe trupave të përhershëm. Respektoni rregullat e mëposhtme:

- Nxënësit që duan të jenë kryetar i bashkësisë së klasës prezantohen para shokëve të klasës dhe shpjegojnë pse ata duhet të jenë ata që zgjidhen si kryetar i klasës. Shokët e klasës u bëjnë pyetje në lidhje me planet e tyre.
- Zgjidhet komision prej tre anëtarësh për të zhvilluar zgjedhjet.
- Nxënësit e tjerë marrin fletë me emrat e shkruar të nxënësve që kanë aplikuar për kryetar të bashkësisë së klasës.
- Votimi duhet të jetë i fshehtë.
- Kryetar zgjidhet nxënësi që ka fituar më shumë vota.
- Zëvendëskryetar zgjidhet nxënësi i cili është në vendin e dytë



BASHKËSIA E KLASËS PERFAQËSON INTERESAT E MIA



KUJTOHU:

Cilat janë trupat e bashkësisë së klasës? Cili është roli i tyre?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Dy shokë të klasës së dytë u grindën. Ata u grindën shumë, madje filluan të shajnë njëri-tjetrin. Kur arsimtarja hyri në klasë, të gjithë papritmas filluan të flisnin dhe t'i tregonin asaj se çfarë kishte ndodhur. Arsimtarja i ndërpreu, sepse nga zhurma nuk kuptoi asgjë. Më pas ajo thirri kryetarin e klasës për t'i shpjeguar se si u krijua sherri..

- Si mund ta zgjidhin nxënësit këtë situatë?
- Si do ta zgjidhnit ju në bashkësinë tuaj të klasës?



2. Nxënësit e klasës së dytë duan të bëjnë ushqyes zogjsh dhe t'i vendosin në oborrin e shkollës.

- Si do të organizohen nxënësit për këtë aktivitet? Kush duhet të marrë pjesë në organizim?



3. Sara dëshiron të ndihmojë gjyshin e vjetër dhe të pafuqishëm që jeton pranë shkollës duke e ndihmuar atë të blejë produkte të nevojshme. Këtë ide ua tha shokëve të klasës.

- Cili është hapi tjetër që duhet të ndërmarë bashkësia e klasës?
- Në çfarë mënyra të tjera mund ta ndihmojnë gjyshin e vjetër?





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Në çfarë mënyre i përfaqëson interesat e tua bashkësia e klasës?
- Pse është e rëndësishme të jesh anëtar aktiv në trupar e bashkësisë së klasës?

- Të gjithë nxënësit nga bashkësia e klasës/bashkësia e paraleles **së bashku pajtohen** dhe zgjidhin ndonjë problem apo nevojë në klasë/paralele. Në mbledhjet e thirrura nga kryetari i bashkësisë së klasës, çdo nxënës ka të drejtë të propozojë ndonjë aktivitet ose zgjidhje për ndonjë problem. Bashkësia e klasës i **përfaqëson interesat** e secilit nxënës.



DETYRË

- Përshkruaj një shembull kur bashkësia e klasës përfaqëson interesat e tua ose interesat e njërit prej shokëve të tu.



AKTIVIZOHU:

Shkruani sugjerimet tuaja për përmirësimin e situatës në paralelen tuaj (marrëdhëniet midis nxënësve, mjetet dhe materialet e nevojshme për klasën tënde, organizimin e një aksioni, ndihmën e një shoku, etj.). Sugjerimet lexoni dhe jepni ato kryetarit të bashkësisë së klasës. Në mbledhjen e ardhshme diskutoni për propozimet.




MARRIM VENDIME NË GRUP

KUJTOHU:

Si sillen zgjidhjet e ndonjë problemi në bashkësinë e klasës?



MENDO DHE PËRGJIGJU



- Lexoji dy situatat, mendo dhe përgjigju cilën prej tyre e miraton dhe cilën nuk e miraton. Shpjego zgjidhjen tënde:
 - Gjatë pushimit para se të fillonte ora e artit, Vasko vuri re se i mungonte blloku. U zemërua dhe e akuzoi Denisin me fjalë ofenduese se ia kishte vjedhur bllokun. Denisi u zemërua dhe e hodhi lapsin në koshin e plehrave. Pati një debat të madh në të cilin u përfshinë të gjithë nxënësit dhe të gjithë morën anën: disa mbrojtën Vaskon, të tjerë Denisin, por asnjëri prej tyre nuk u dorëzua.
 - Arsimtarja i njoftoi nxënësit e klasës së dytë se do të hulumtojnë bujqësinë dhe tregtinë. Për këtë qëllim duhet të zgjedhin se a do të vizitojnë një treg apo një dyqan fruta-perimesh. Pas orës Fadili, i cili është kryetar i bashkësisë së klasës, thirri një mbledhje për të vendosur se çfarë do të zgjedhin.
- Në çfarë mënyre bashkësia e klasës në shembullin e dytë solli vendim për zgjidhje të problemit?
- Çfarë duhet të ekzistojë që bashkësia e klasës të funksionojë me sukses?
- Si duhet të marrin vendime anëtarët e bashkësisë së klasës?
- Çfarë duhet respektuar gjatë marrjes së vendimeve në bashkësinë e klasës?
- Çfarë do të bënin nëse dikush do të thyente rregullat të cilat së bashku i keni sjellë?



- Që bashkësia e klasës të funksionojë me sukses duhet të sillni rregulla për punës. Rregullat sillen së bashku. Ato ndihmojnë punën e grupit për të ecur si duhet dhe me sukses. Çdo anëtar i bashkësisë së klasës
- kontribuon në punën e suksesshme nëse respektohen rregullat e miratuara. Nëse dikush nuk bindet dhe i thyen rregullat e grupit, ai duhet t'i pranojë pasojat.



DETYRË

1. Duke shkruar thënien, përgjigju si duhet të sillesh kur punon në grup, pra kur punon në bashkësinë e klasës. Përdor fjalët e ofruara nga **banka e fjalëve**:
 - a) Secili prej nesh ka të drejtë të shprehë _____ e tij.
 - b) Kur dikush flet, ju nuk duhet ta _____ .
 - c) Duhet ta _____ mendimin e dikujt tjetër.
 - ç) Vendimet i marrim me anë të _____ .
 - d) Anëtarët duhet të _____ dhe _____ reciprokisht..
 - dh) Nëse dikush i thyen rregullat, duhet t'i pranojë _____ .

BANKA E FJALËVE:



Përcaktoni së bashku rregullat për punë. Duke vepruar kështu, respektoni rregullin që çdo nxënës ka të drejtë të shprehë mendimin e tij. Shkruajini ato në një fletë të madhe letre dhe shfaqini në klasë. Rregullat lini të shërbejnë si udhërrëfyes kur mbani mbledhje të bashkësisë së klasës. Merruni vesh për atë që do të bëni nëse dikush i thyen rregullat.

CILËSITË E DËSHIRUESHME TË NXËNËSVE



SI TË ARRINI SUKSES?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Nxënësit e klasës së dytë janë marrë vesh të organizojnë një aksion ekologjik për seleksionimin e mbetjeve nga oborri i shkollës. Kur filloi aksioni, Renata u ul në stolin e oborrit dhe bëri sikur i lidh atletet, e kopsit xhaketën, pastaj kontrollon xhepat për diçka. Shokët e saj e vunë re, por nuk thanë asgjë. Ata vazhduan punën me zell.



- Çfarë mund të përfundosh nga ky shembull, çfarë cilësie ka Renata, e çfarë shokët e saj? (Rretho).

Renata:

- a) kureshtarë
- b) nuk është punëtore
- c) shoqe e mirë

Shokët:

- a) punëdashës
- b) nuk janë punëdashës
- c) shokë egoistë

- Çfarë cilësie është punëdashësia?
- Jep shembull se kur ke qenë punëdashës dhe çfarë ke arritur me punën tënde të palodhur? Si u ndjeve atëherë?



MENDO DHE PËRGJIGJU

2. Dona dhe Damiri janë në klasë të dytë dhe së fundmi kanë filluar të luajnë basketboll. Ata nuk kanë shënuar ende asnjë kosh. Të gjithë u thonë se janë të vegjël, por dëshira e tyre më e madhe është të mësojnë të luajnë basketboll si basketbollistë profesionistë. Prandaj çdo pasdite, pasi mbarojnë detyrat e shtëpisë, ushtrojnë basketboll në oborrin e tyre. Ata ishin këmbëngulës dhe të durueshëm dhe janë përpjekur që gjatë gjithë javës të shënojnë një kosh. Më në fund ia dolën. Ata u gëzuan pa masë. Këmbëngulja shpërblehet.



- Çka mund të përfundosh nga ky shembull, çfarë cilësie kanë Dona dhe Damiri? (Rretho).

Ata janë:

- | | |
|--------------|----------------|
| a) egoistë | c) këmbëngulës |
| b) të gëzuar | d) kuriozë |

- Çfarë cilësie është këmbëngulja?
- Jep shembull kur ke qenë këmbëngulës në diçka. Çfarë ke arritur? Si u ndjeve atëherë?



MENDO DHE PËRGJIGJU

3. Arsimitarja u shpjegoi nxënësve të klasës së dytë se si duket fshati dhe si duket qyteti. Kur shkoi në shtëpi, Ivica donte të dinte si duken fshatrat në botë. Ai i kërkoi motrës së tij të madhe që ta ndihmonte të kërkonte në internet, por kërkoi edhe nëpër gazeta për të zbuluar diçka të re që nuk e dinte më parë. Ivica befasoi këndshëm arsimtaren dhe shokët e tij me hulumtimin e tij. Ai ishte kurioz të zbulonte diçka të re. Kjo do t'i shërbejë që të mësojë më shumë.



- Çka mund të përfundosh nga ky shembull, çfarë cilësie posedon Ivica? (Rretho).

Ivica është:

- a) i sjellshëm
- b) egoist
- c) kurioz
- d) i durueshëm

- Çfarë cilësie është kurioziteti?
- Jep shembull si ke arritur me kuriozitet? Si u ndjeve atëherë?



- Çka përfundove nga shembujt e mëparshëm, cilat cilësi duhet t'i kesh për të arritur sukses në mësim?



Zelli, këmbëngulja dhe kurioziteti janë tipare pozitive që çojnë drejt suksesit në mësim. Ato janë cilësi që i fiton në shtëpi, në shkollë dhe në komunikimin e përditshëm me të tjerët. Mundohu të jesh gjithmonë i zellshëm, këmbëngulës në punën tënde dhe kurioz për të zbuluar gjëra të reja.



DETYRË

- Lidhi pohimet nga kolonat për të bërë një fjali që do të tregojë cilësitë të cilat duhet t'i posedosh:



Nëse dua të mësoj të lexoj rrjedhshëm dhe saktë, duhet të jem

i zellshëm/ e zellshme

Që të mësoj dhe të dimë shumë përrregullate trafikut duhet të jem

kurioz/ kurioze

Që të jem i kënaqur/e kënaqur me punën e bërë duhet të jem

këmbëngulës/ këmbëngulëse

BASHKËPUNOJ ME SHOKËT



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Nxënësit e klasës së dytë përgatisin një shfaqje. Të gjithë marrin pjesë në një moment të ngjarjes. Leoni e mësoi mirë tekstin dramatik. Ai

përgjegjshëm u vendos ndaj detyrës së tij.


- Pas çfarë konkludove se Leoni iu afrua me përgjegjësi detyrës së caktuar?
- Çfarë cilësie është përgjegjësia?
- Jep shembull kur ke qenë përgjegjës në një situatë.
- Çfarë do të ndodhë nëse dikush nuk është përgjegjës për detyrat e tij?



2. Duke ecur nëpër korridorin e shkollës, Fatmiri gjeti një çantë për lapsa. E ngriti nga dyshemeja por nuk e hapi. Menjëherë ia çoi mësueses dhe ia dha.

Ndershmëria e Fatmirit kontribuoi që Lejla ta marrë çantën me lapsa.

- Çfarë cilësie posedon Fatmiri?
- Çfarë do të thotë të jesh i ndershëm?
- Jep shembull të një situatë në të cilën ti ose dikush tjetër je sjellë me ndershmëri.
- Çfarë do të ndodhë nëse dikush nuk është i ndershëm?





MENDO DHE PËRGJIGJU

3. Nxënësit e klasës së dytë janë marrë vesh të mbjellin lule në oborrin e shkollës. Njëri grup mbolli lulet, kurse grupi tjetër i ujiti me ujë. Kur grupi i parë mbaroi punën e tyre, ata ndihmuan grupin e dytë. Nxënësit e kësaj klase **bashkëpunuan** me njëri-tjetrin dhe për këtë arsye e përfunduan punën shpejt dhe me sukses.

- Pse nxënësit e klasës së dytë e përfunduan punën shpejt dhe me sukses?
- Pse është e rëndësishme të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin?
- Jep shembuj si bashkëpunoni me njëri-tjetrin në klasën tënde.
- Çfarë do të ndodhë nëse nuk bashkëpunoni me njëri-tjetrin?
- Jep shembuj të përgjegjësisë, ndershmërisë dhe bashkëpunimit nga jeta e përditshme, jashtë shkollës.



- **Përgjegjësia, ndershmëria dhe bashkëpunimi** janë cilësi pozitive. Ato të ndihmojnë që të jesh i vlerësuar dhe i respektuar nga të tjerët.
- Mundohu të jesh gjithmonë i përgjegjshëm ndaj punës dhe të tjerëve, i ndershëm në veprimet e tua dhe bashkëpunues në punën e përbashkët.



DETYRË

Shikoji ilustrimet dhe nën to shkruaji cilësitë e fëmijëve të cilët janë treguar:



SJELLJA NË SHKOLLË

SI KOMUNIKOJ?



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Shiko ilustrimet, se çfarë flasin shokët midis tyre dhe shpjego si sillen njëri me tjetrin:

Faleminderit që
më ndihmove të
zgjidh detyrën.



E gjeta
këtë laps.
Ndoshta
është i yti?



Po,
faleminderit
shumë!



Të enjten do të kemi
ndeshje tenisi.
A dëshiron të bashkohesh
me ekipin tonë?



Po, me
kënaqësi!



DETYRË

- Mendo se si komunikoni në klasën tënde. Cilat fjalë i përdor më shpesh kur komunikon me shokët e tu? (Shkruaji ato në vendet e zbrazëta).



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Me cilat fjalë do të kërkoresh ndihmë nga shoku yt? Si do të ndihesh nëse dikush nuk dëshiron të të ndihmojë? E si do të ndihesh nëse nuk je i ftuar të luash së bashku ose dikush të ofendon?
- Përshkruaj një situatë në të cilën ke parë/dëgjuar ose përjetuar dikë duke përdorur fjalë ofenduese ose tallëse. Si janë ndjenë ata fëmijë apo si u ndjeve ti?
- Si mund të shmangen situata të tilla? Çfarë duhet të bësh atëherë?

- Të rriturit dhe fëmijët në komunikimin e tyre me të tjerët përdorin komunikim jo të dhunshëm, por ndonjëherë edhe komunikim të dhunshëm.
- Komunikimi i dhunshëm është sjellje negative e njerëzve. Duke vepruar kështu, përdoren fjalë fyese, tallje, egoizëm dhe papërgjegjësi. Bëj përpjekje kur komunikon të përdorësh komunikim jo të dhunshëm duke përdorur fjalë të mira, duke respektuar të tjerët dhe duke qenë përgjegjës në sjelljen tënde. Në këtë mënyrë do të jesh i respektuar dhe i dashur nga të tjerët.



AKTIVIZOHU:

Vizato një strip me 3-4 skena në të cilat do të tregosh përdorimin e komunikimit jo të dhunshëm në zgjidhjen e një problemi në paralelen tënde.




SI SILLEM?



MENDO DHE PËRGJIGJU



- Shiko ilustrimet, cakto se cilën sjellje e arsyeton dhe cilën nuk e arsyeton dhe shpjego pse? (Situatën që nuk e arsyeton shlyeje me të kuqe).



- Cili rregull i sjelljes është shkelur në ilustrimet e treguara?
- Cila nga situatat e treguara ka ndodhur në klasën tënde? Çka ishte shkaku që ato të ndodhin? Si ke vepruar në ato situata?
- Cilat janë pasojat e sjelljes agresive?
- Shpjego si mund të parandalohet sjellja agresive e një prej shokëve të tu?

- Çdo problem mund ta zgjidhësh në një mënyrë të qetë. **Sjellja**
- **agresive** është veprim negativ që shkakton dëm për njerëzit e tjerë,
- rrethinën ose veten. Problemet zgjidhi përmes bisedës, marrëveshjes
- dhe bashkëpunimit me të tjerët. Në këtë mënyrë do të zbatosh **sjellje**
- **jo agresive** që do të jetë gjithmonë e suksesshme.



DETYRË

Shiko ilustrimet dhe mendo cila do të jetë pasoja e sjelljes agresive dhe si do ta zgjidhësh:

SHKAKU



PASOJA


ZGJIDHJA



E RESPEKTOJ MENDIMIN E TË TJERËVE

KUJTOHU:


Cilat rregulla të punës në grup i keni sjellë në klasën/paralelen tuaj?
Si e zbatoni rregullin: Respektoni mendimin e tjetrit?



MENDO DHE PËRGJIGJU

Gjatë aktiviteteve të lira nxënësit e klasës së dytë bënë një robot nga materialet e mbeturinave. Grupi i parë donte që roboti të ishte i gjelbër sepse e gjelbra është ngjyra e ekologjisë, kurse grupi tjetër donte që ai të ishte i përhirtë metalik sepse robotët janë prej metali. U grindën çfarë ngjyre duhet të jetë roboti. Askush nuk e respektoi mendimin e tjetrit.

- Pse u grindën të dy grupet?
- Si do ta zgjidhësh këtë situatë?



Bisera mëson t'i bjerë daulleve. Liles nuk i pëlqejnë daullet sepse mendon se janë shumë të zhurmshme. Në shkollë Bisera tregoi se si duhet t'i bihet daulleve dhe sa interesante është t'i biesh atyre. Lile nuk e ndërpreu derisa ajo shpjegonte, edhe pse mendonte se kitara tingëllon më mirë se daullet. Ajo e respekton mendimin e Biserës, por ka edhe mendimin e saj.

- Si tregoi Lile se e respekton mendimin e Biserës?
- Në çfarë mënyre mund ta shprehë Lile mendimin e saj?
- Pse është e rëndësishme të respektohen mendimet e të tjerëve?
- Pse është e rëndësishme të thuash mendimin tënd?



Që dikush të respektojë mendimin tënd, edhe ti duhet të respektosh mendimin e tyre. **Do të tregosh respekt për mendimin** e të tjerëve nëse:

- e dëgjon derisa flet
- nuk e ndërpret derisa flet
- e pret radhën tënde për të shprehur mendimin tënd
- bëhesh i sjellshëm me personin tjetër edhe nëse nuk je dakord me mendimin e tij
- mendimin tënd e shpreh pa u grindur.




DETYRË



Shiko ilustrimet dhe vendose shenjë✓ në rrethin e zbrazët nëse mendon se respektohet mendimi i të tjerëve, kurse shenjë✗ku nuk respektohet dhe shpjego si duhet zgjidhur situata në të cilën mendimi i të tjerëve nuk respektohet:

- Mersiha: Jam e paduruar të filloj të hulumtoj për kafshët. I dua shumë gjirafat, mendoj se janë krijesat më të bukura në këtë planet.
- Pjetri: Hëmm, sipas meje ato janë delfinët, por prapë dua të mësoj diçka për gjirafat.



- Kujtimi: Sot do të luajmë futboll, sepse të gjithë e duan futbollin.
- Vllatko: Nuk është e vërtetë! Hendbolli është më interesant sepse është sport i shpejtë, futbollin nuk është aspak interesant.
- Kujtimi: Jo, jo, unë vendosa: ose futboll ose asgjë tjetër.
- Vllatko: Epo, edhe unë vendosa: ose hendboll ose asgjë tjetër.



TË GJITHË JEMI TË BARABARTË – DJEM DHE VAJZA



MENDO DHE PËRGJIGJU



1. Në shkollë bëhet shpallja për regjistrimin e anëtarëve në klubin për kultivimin e luleve.

U lajmëruan të gjitha vajzat në klasë. Kur Jane donte të regjistrohej, shokët e tij filluan t'ia ndryshojnë mendjen: "Në atë klub shkojnë vetëm vajzat", "Çfarë? A mos je vajzë?"

- Çka mendon për sjelljen e shokëve të Janes?
- Pse djemtë nuk u regjistruan? A e pranon këtë?
- Si do të veproje në vendin e:

Janes: _____

Shokëve: _____

Shoqeve: _____

2. Nxënësit e klasës së dytë organizojnë një festë ditëlindjeje për shokun e tyre. Secili kishte marrë një detyrë: djemtë të sillnin gjërat e nevojshme dhe vajzat të dekoronin tortën. Merali donte shumë t'i ndihmonte djemve, por shoqet e ndaluan: "Ti je vajzë dhe duhet të na ndihmosh neve".



- Pajtohem si nxënësit i kanë ndarë detyrat (rretho dhe shto).

PO

Sepse:

JO

Sepse:



MENDO DHE PËRGJIGJU

3. Jep shembull nëse je pënguar ndonjëherë nga dikush që të bësh diçka ngase je vajzë/djalë. Si veproje atëherë? Si u ndjeve?
4. A ka aktivitete që janë të përshtatshme vetëm për djem dhe vetëm për vajza?



DETYRË



Shkruaje shenjë  pranë thënies me të cilën pajtohesh kurse shenjë  pranë thënies me të cilën nuk pajtohesh dhe shpjego pse:

- a) Djemtë nuk duhet të ushtrojnë balet sepse është për vajza. _____
- b) Vajzat nuk duhet të luajnë futboll, sepse vetëm djemtë luajnë futboll. _____
- c) Në shfaqjen e shkollës në pikën muzikore duhet të marrin pjesë edhe djemtë edhe vajzat. _____



AKTIVIZOHU:


Gjatë një jave në tabelë në një kolonë shëno shembuj të ndarjes së padrejtë të djemve dhe vajzave, kurse në kolonën e dytë shëno shembuj të sjelljes së drejtë ndaj djemve dhe vajzave. Në fund numëroji rezultatet dhe diskutoni në cilën kolonë ka më shumë raste, pse ka dhe çfarë mund të bëhet në lidhje me ata shembuj.



TË GJITHË JEMI TË BARABARTË – GJUHA NUK ËSHTË PENGESË PËR MIQËSI

KUJTOHU:

Në çfarë gjuhe flet?
A ke shokë që flasin në gjuhë tjetër?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Shiko ilustrimin dhe mendo në cilën gjuhë flasin shokët midis tyre:



- Nga e di se ata flasin në atë gjuhë?
- A flasin të gjithë fëmijët në fushë lojërash të njëjtën gjuhë?
- Djemtë me top flasin gjuhë të ndryshme, por megjithatë e kuptojnë njëri-tjetrin. Shpjego si arrijnë të kuptohen midis tyre.



MENDO DHE PËRGJIGJU

2. Supozo çfarë bisedojnë shokët midis tyre. Imagjino se bisedojnë në gjuhë të ndryshme.

- Si sillen njëri ndaj tjetrit?



3. Çfarë do të bësh nëse dikush të drejtohet në gjuhë tjetër?
4. Cilat gjuhë fliten në shkollën tënde?
5. Si merresh vesh me shokët e tu që flasin gjuhë të tjera në shkollë?
6. Çfarë do të bësh nëse dikush nuk e kupton gjuhën tënde dhe ti duhet të merresh vesh për ndeshjen e nesërme në tenis?

- Njerëzit flasin gjuhë të ndryshme. Pavarësisht se çfarë gjuhe flisni ti dhe shoku yt, duhet ta respektoni me njëri-tjetrin. Kështu më lehtë do të kuptoheni. Për të komunikuar më mirë me njëri-tjetrin, përpiku të mësonsh gjuhën e shokut, kurse ai gjuhën tënde.



AKTIVIZOHU:

- Zbulo si do të thuash PËRSHËNDETJE në maqedonisht, në turqisht, në gjuhën rome, serbisht dhe boshnjakisht.
- A di të thuash PËRSHËNDETJE në gjuhë tjetër dhe nëse di, tregoj shokëve të tu.

TË GJITHË JEMI TË BARABARTË – MËSOJME SË BASHKU



MENDO DHE PËRGJIGJU

Sipas ilustrimit dhe shpjegimit të tij, cakto se çfarë munden/dinë fëmijët e paraqitur dhe çfarë nuk munden/nuk dinë:

Unë nuk di të notoj, por di të kërcej.

Unë nuk mund t'i ngjit shkallët, por kjo është arsyeja pse luaj mirë shah.

Mua më duhet më shumë kohë për të shqiptuar një fjalë, por prandaj shkruaj mirë tregime.

Unë nuk di si t'i lidh lidhësit e këpucëve, por mund të vrapoj shpejt.



- Çfarë ndihme ose mbështetje iu nevojitet fëmijëve në ilustrim?
- Si mund t'i ndihmosh?
- Cili fëmijë ka nevojë më shumë për ndihmë?
- Mendo dhe thuaj se a ke nevojë ndonjëherë për ndihmë për diçka? Kush mund të të ndihmojë? Si mund të të ndihmojë?
- Mendo dhe thuaj si e ndihmove shokun tënd që kishte nevojë për ndihmë ose mbështetje.

Çdo fëmijë di dhe mund të bëjë diçka, por ka disa gjëra që ai nuk mundet ose nuk di t'i bëjë. Prandaj i duhet ndihmë dhe mbështetje nga të tjerët.

Disa fëmijëve u duhet më pak ndihmë, kurse disa të tjerëve më shumë ndihmë.

Disa fëmijë kanë vështirësi në ecje dhe kanë nevojë për ndihmë për të kaluar ndonjë pengesë ose për të kryer ndonjë aktivitet tjetër fizik. Disa fëmijë kanë probleme me shikimin. Ata kanë nevojë për ndihmë që të lëvizin të sigurt nëpër hapësirë ose për të lexuar. Disa fëmijë kanë vështirësi në të folur. Ata kanë nevojë për mbështetje që të mund të kuptohen mirë me fëmijët e tjerë.

Disa fëmijë kanë vështirësi në dëgjim. Edhe atyre u nevojitet mbështetje për të kuptuar se çfarë flasin të tjerët.

Fëmijët, por edhe të rriturit duhet të respektohen midis tyre pavarësisht nga **aftësitë** e tyre. Këtë do ta tregosh nëse e respekton mendimin e tyre, ndihmoji ata dhe përpiku të kapërcesh dallimet mes jush.



DETYRË

- Lexoji pyetjet dhe rretho përgjigjen që mendo se është e përshtatshme:

1. Suzanës i ra libri i saj në dysHEME. Nuk mund ta marrë sepse lëviz me ndihmën e karrocës me rrota dhe nuk mund të përkulet. Çfarë duhet të bëjë Ane e cila e pa:

- t'ia dorëzojë asaj librin
- ta lërë që atë ta bëjë dikush tjetër
- të shtirret sikur nuk e pa

2. Në klasën tënde ke një shok me dëgjim të zvogëluar. Si do ta ndihmosh shokun tënd të kuptojë atë që thua:


- do të bërtas me zë të lartë që ai të më dëgjojë
- do të flas ngadalë në mënyrë që ai të ndjekë atë që them dhe "të lexojë nga buzët"
- do të përpiqem të mësoj gjuhën e shenjave në mënyrë që të kuptohemi më lehtë



A E DI SE:

Njerëzit që kanë dëmtime në shikim përdorin shkrim të veçantë të quajtur shkrimi i Brailit.

Ai është i përbërë nga pika të ngritura dhe përdoret me prekje të gishtave.



A E D I SE:

Njerëzit që kanë dëmtime në dëgjim dhe/ose në të folur, përdorin gjuhën e shenjave duke përdorur duart dhe gishtat. Ata gjithashtu mund të përcjellin çfarë thua duke lexuar fjalët nga buzët e tua.

Alfabeti me një dorë



Shkronja A



Shkronja V




Shkronja D




Shkronja I



Numri 1



Numri 2



Numri 3



Numri 4



Numri 5



AKTIVIZOHU:

Me ndihmën e arsimtares në internet zbuloni si të mësoni gjuhën e shenjave. Përpiquni të mësoni disa shkronja ose fraza që do t'ju ndihmojnë të komunikoni me shokun tënd me probleme në dëgjim ose në të folur.



TEMA 2: NË SHTËPI



TEMA 2: NË SHTËPI



FAMILJA MË E GJERË DHE FESTIMET FAMILJARE

- Familja ime më e gjerë
- Familja ime feston
- Si përgatitemi për festë



HAPËSIRAT, MOBILJET DHE APARATET NË SHTËPI:

- Hapësirat dhe mobiljet në shtëpinë time
- Aparatet në shtëpi dhe përdorimi i sigurt i tyre




CILËSITË E DËSHIRUARA TË FËMIJËVE NË SHTËPI/FAMIJE



MBROJTJA NGA FATKEQËSITË ELEMENTARE:

- Zjarri
- Përmbytja
- Tërmeti





Familja ime përbëhet ngaanëtarë.

Emrat e tyre janë:

.....


Unë jetoj në (shtëpi/banesë).....

FAMILJA MË E GJERË DHE FESTAT FAMILJARE

FAMILJA IME MË E GJERË

KUJTOHU:

Nga cilët anëtarë përbëhet familja jote?
Cilët anëtarë të tjerë të familjes i njeh, kurse nuk jetojnë me ju?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Adelina është në shëtitje me familjen e saj: nënën, babain, motrën, vëllain e vogël dhe anëtarët e familjes së saj më të gjerë: kushërinjtë, daja, teza, halla, gjyshja, gjyshi, xhaxhai dhe grua ja e xhaxhait. Kur mbërritën të gjithë, bënë një fotografi për të kujtuar ditën kur u bashkua e gjithë familja e ngushtë dhe e gjerë së bashku. Në shtëpi Adelina e shikonte fotografinë dhe e pyeti nënën e saj:
 - Mami, pse dajën Tarik nuk mund ta thërras xhaxha?
 - Cili është dallimi midis dajës dhe xhaxhait?
 - Për cilët të afërm thua se i ke kushërinj?





MENDO DHE PËRGJIGJU



2. Përcakto lidhjet familjare si në këtë shembull

- a) xhaxhai është vëllai i babait
- b) xhaxhesha është
- c) daja është
- ç) dajesha është
- d) halla është

3. Çfarë je ti për hallën/tezen/xhaxhain/dajën tënd?

.....

4. Në çfarë mënyre u tregon anëtarëve të familjes sate më të gjerë se i do dhe i respekton?



- Anëtarët e **familjes së gjerë** janë:
- Gjyshi dhe gjyshja (prindërit e prindërve tuaj), halla (motra e babait), tezja (motra e nënës), xhaxhai (vëllai i babait), xhaxhesha (gruaja e xhaxhait tënd), daja (vëllai i nënës), dajesha (gruaja e dajës) dhe kushërinjtë.



- Të gjithë këta janë të afërmit tënd me të cilët duhet të respektoheni, të shoqëroheni, të ndihmoheni dhe të mbështeteni.



DETYRË



1. Shpjego se si je i lidhur me anëtarët e familjes sate më të gjerë:

a) Më pëlqen ta kaloj kohën e lirë me

.....

b) Më interesant është me

.....

c) Dua të shkoj në piknik me

.....

ç) Më ndihmon më shumë

.....



FAMILJA IME FESTON



MENDO DHE PËRGJIGJU

Andrea ka ditëlindjen. Është shumë e lumtur sepse në ditëlindjen e saj do të vijë shumë mysafirë. Madje e mësoi edhe këngën “Ditëlindja” që të mund të këndojë së bashku me mysafirët. Ajo di se çfarë të bëjë kur do të vijë mysafirë. Ja çfarë tha:



- Së pari do t’i përshëndes dhe do t’u them: “Mirëserdhët në ditëlindjen time”. Do t’i falënderoj për dhuratën dhe nuk do të më vijë keq nëse dhurata nuk më pëlqen, sepse nuk është kulturore.
- Pastaj do t’u ofroj të ulen dhe të ndihen të mirëseardhur.
- Kur të vijë radha për të prerë tortën, do të këndojmë këngën, kurse pastaj do t’i fik qirinjtë. Dhe po, do të imagjinoj një dëshirë.
- Para se të largohen mysafirët do t’i falënderoj që erdhën.

Përgjigju:

- Si duhet të sillesh në ditëlindjen tënde?
- Pse festohet ditëlindja?
- Cilat festa të tjera në familje i di?





MENDO DHE PËRGJIGJU

Kjo familje u mbledh për të festuar ditën e lindjes së gjyshes Maria.

- Pse festohet dita e lindjes?
- Si urohet dita e lindjes?



Kjo familje u mbledh për të festuar kremten shtëpiake.

- Pse festohet kremtja shtëpiake?
- Kur festohet kremtja shtëpiake?
- Si festohet kremtja?



Kjo familje e feston martesën:

- Pse festohet martesa?
- Nëse ke marrë pjesë në martesë, përshkruaj si u festua.





MENDO DHE PËRGJIGJU




- Në cilat festime të tjera familjare ke marrë pjesë në familjen tënde më të gjerë?
- Si duhet të sillesh në festën familjare?

- Në familjen tënde më të ngushtë dhe më të gjerë organizohen
- **festime familjare** siç janë ditëlindjet, ditët e lindjes, kremtja
- shtëpiake, dasmat. Kur merr pjesë në festime të tilla, duhet të
- sillesh në mënyrë të kulturuar, me edukatë dhe sjellje të mirë ndaj
- të tjerëve, e nëse je nikoqiri i festës, duhet të jesh edhe mikpritës
- dhe i sjellshëm me mysafirët.




Çfarë duhet të bëj kur jam mysafir ose kur pres mysafirë:

- Përhëndetem me mysafirët.
- Kur përshëndetem buzëqesh me dashamirësi dhe i shikoj në sy. Iu dëshiroj mirëseardhje.
- Nuk flas me zë të lartë dhe nuk bërtas.
- Nëse kam nevojë për diçka, do ta pyes me dashamirësi nikoqirin e festës.
- Kur do të largohem i përshëndes edhe mysafirët dhe nikoqirët e tjerë.
- Para se të largohem falënderoj nikoqirët për mirëpritjen.





DETYRË



Plotësoji thëniet e mëposhtme

a) Kur shkoj në ndonjë festë përshëndes me fjalët:

.....

b) Kur mysafirët vijnë në festën time, i përshëndes me fjalët:

.....

c) Gjatë kohës së festës duhet të sillem


.....



AKTIVIZOHU:

1. Bëj ftesë për një festë që do ta festoni në familjen tënde. Mos harro të shkruash kohën, vendin dhe rastin e festës. Zbukuroje, shkruaje, më pas dërgoje ose dorëzoje personalisht ftesën te personi që dëshiron të marrë pjesë në atë festë.

2. Bëj kartolinë me të cilën do të urosh ndonjë festë të një anëtarit të familjes më të ngushtë ose më të gjerë. Zbukuroje kartolinën dhe shkruaji urimet e tua të singerta me rastin e festës.



SI PËRGATITEMI PËR FESTË



MENDO DHE PËRGJIGJU



Ditëlindja e Onisit po afron. Ai është i lumtur që ka mysafirë. Por, para se të mbërrijnë mysafirë, Onisi dhe prindërit e tij e përgatisin festën e ditëlindjes. Pak ditë më parë Onisi u dërgoi ftesa për ditëlindje anëtarëve të familjes më të gjerë, por edhe shokëve dhe fqinjëve të tij. Para festës nëna dhe vëllai i tij e zbukuruan dhomën ku do të vijnë mysafirët. Babai dhe motra e tij e shtruan tryezën festive. Por torta? Tortën e kanë zbukuruar Onisi dhe shoqja e tij Maja. Pastaj Onisi u vesh me rroba të pastra dhe të bukura, kurse këtë e bënë edhe anëtarët e familjes së tij. Gjithçka ishte gati për të pritur mysafirët.

- Si përgatitesh për ditëlindjen tënde?
- Si përgatitesh nëse je i ftuar në ditëlindje?





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Çfarë vesh kur feston apo shkon në festë?
- Si do të vishesh nëse do të ishe i ftuar në dasmë?
- Çfarë do të veshësh nga rrobat e propozuara nëse do të duhet të shkosh në ditëlindje:



- Si e kupton se tryeza është solemne dhe jo e përditshme?



- Shiko ilustrimin, mendo dhe shpjego si sillen fëmijët gjatë kohës së ngrënies.
- Çfarë nuk lejon nga sjellja e tyre?
- Si duhet të sillen?





Si sillem gjatë kohës së ngrënies:

- Para ngrënies i laj duart me sapun dhe me ujë.
- Nëse ha me njerëz të tjerë, i uroj ata: "Ju bëftë mirë".
- E mbaj pirunin ose lugën me dorën e djathtë. Nëse përdor thikë, e mbaj thikën me dorën e djathtë, kurse pirunin me dorën e majtë.
- Gjatë dhe pas ngrënies fshihem me pecetë.
- Nuk luaj me ushqimin.
- Përtyp me gojë të mbyllur dhe nuk flas gjatë përtypjes.
- Pasi ngrënies ndihmoj në pastrimin e tavolinës.




- Festimet janë ngjarje kur festohet diçka.
- Për ato festa duhet të përgatitesh në atë mënyrë që ajo të jetë e këndshme për mysafirët. Me sjelljen tënde gjatë festës do të tregosh se je fëmijë i kulturuar, i sjellshëm dhe i edukuar.



AKTIVIZOHU:

1. Në klasë dramatizoni si duhet të organizoni dhe të merrni pjesë në ndonjë festë. Diskutoni se cilat janë rregullat për sjelljen në festë.
2. Shkruaj dhe vizato rregulla se si duhet të sillesh gjatë kohës së ngrënies.




HAPËSIRAT, MOBILJET DHE APARATET NË SHTËPI

HAPËSIRAT DHE MOBILJET NË SHTËPINË TIME

KUJTOHU:

Cilat hapësira gjenden në shtëpinë tënde?
Për çfarë shërben secila nga ato hapësira?
Në cilën hapësirë qëndron më shumë?
Cila hapësirë është më e rehatshme për ty për të qëndruar?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Në ilustrimin e mëposhtëm emërtoji hapësirat dhe mobiljet në shtëpi:





MENDO DHE PËRGJIGJU



2. Sipas ilustrimit të dhënë përshkruaj dhe shpjego për çka shërbejnë mobiljet në çdo hapësirë të shtëpisë.
2. Përshkruaji mobiljet në një hapësirë të shtëpisë sate.
3. Si duhet të kujdesesh për hapësirat dhe orenditë në to?

- Çdo hapësirë në shtëpi ka qëllimin e vet. Sipas qëllimit të dhomës
- ka edhe mobilie që u shërbejnë nevojave të familjarëve. Hapësirat
- dhe mobiljet në shtëpi duhet të mbahen të pastra dhe të
- rregulluara.



DETYRË

Lidhi hapësirat e shtëpisë me ilustrimin përkatës të mobiljeve:



Dhoma e ditës

Dhoma për fëmijë

Bodrumi/izba

Korridori

Tualeti



APARATET NË SHTËPI DHE PËRDORIMI I SIGURT I TYRE



MENDO DHE PËRGJIGJU


1. Babai i Teodorit dëshiron të bëjë petulla. Merr vaj, vezë, miell dhe qumësht. Pasi t'i skuqë do t'i lyejë me marmelatë.

- Me çfarë do t'i përziejë përbërësit?
- Me çfarë do t'i skuqë petullat?
- Ku ruhen marmelata dhe vezët?



2. Jane u kthye nga trajnimi i futbollit. Këmisha dhe pantallonat e shkurtra i ishin njollosur.

- Ku duhet t'i vendosë rrobat e tij të njollosura?




3. Gjyshi i Jonuzit shumë dëshiron të shikojë emisione për botën e kafshëve.

- Si quhet aparati në të cilën gjyshi i Jonuzit i shikon emisionet?



4. Cilat aparate i përmende kur iu përgjigje pyetjeve?
5. Emërtoji aparatet e tjera që përdoren në shtëpi.
6. Cili është qëllimi i çdo aparati që i numërove?
7. Përshkruaje mënyrën se si përdoren aparatet që i numërove.
8. Cilat aparate mund t'i përdorësh?




- Në shtëpi përdoren aparate të ndryshme. Ato lehtësojnë punën e
- anëtarëve të familjes. Disa aparate punojnë me energji elektrike,
- kurse disa të tjera me bateri. Shmang përdorimin e aparateve
- elektrike sepse ekziston rreziku i goditjes elektrike ose zjarrit nëse
- përdoren në mënyrë jo të duhur.

MBAJ MEND!

Nuk duhet të përdorësh ndonjë aparat elektrik nëse je vetëm në shtëpi.

Gjithmonë kontrollo që aparati elektrike të jetë i fikur pas përdorimit.


KI KUJDES NË PUNËT E MËPOSHTME:



Mos përdor aparat elektrik që ka kablllo të dëmtuar.



Mos përdor aparat elektrik me duar të lagura.




Mos e fik aparatin duke e tërhequr kabllon.



Shmangi vendet ku qëndron kjo shenjë.

DETYRË



Shiko ilustrimet dhe përgjigju në kërkesat:

- Emërtoji aparatet.
- Për çfarë përdoret secila prej këtyre aparateve?
- Shpjego se si përdoret secila prej tyre.
- Si do të mbrohesh nga pasojat e padëshiruara kur i përdor aparatet e përmendura në shtëpi?


APARATET PËR AMVISËRI



CILËSITË E DËSHIRUARA TË FËMIJËVE NË SHTËPI/FAMIJE

KUJTOHU:

Cilat janë obligimet e tua në shtëpi?
A i përmbahesh obligimeve të tua në shtëpi?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Sa herë që Milla i lan dhëmbët, e mbyll çezmën në mënyrë që uji të mos rrjedhë pa nevojë. Kështu, ajo e kursen ujin. Kur shkon për të fjetur e fik dritën. Kështu, e kursen energjinë elektrike. Në mëngjes e rregullon shtratin dhe e lë dhomën të pastër dhe të rregulluar. Pasi të hajë mëngjes, e ngre tavolinën. Para se të shkojë në shkollë edhe një herë e kontrollon çantën e shpinës së shkollës për librat e nevojshëm, fletoret dhe mjetet shkollore, e mbyll derën dhe shkon në shkollë. Ajo sillet me *përgjegjësi* ndaj obligimeve të saj.



- Si sillesh ndaj obligimeve të tua në shtëpi?
- Numëro disa shembuj të sjelljes së përgjegjshme.
- Pse duhet të jesh i rregulluar?



2. Kujtimi është fëmijë i **kujdesshëm**.

Atë e tregon në mënyra të ndryshme.


Kujdeset për gjyshen e tij: e viziton rregullisht, flet me të dhe pyet për shëndetin e saj. Ai gjithashtu kujdeset për vëllain e tij të vogël: e ndihmon të vishet, i mëson lojëra të reja dhe kujdeset që të mos lëndohet gjatë lojës. Kujtimi ka një qenush të vogël. Emri i tij është Baks. Ai i jep të hajë rregullisht, e merr për shëtitje dhe luan me të. Kujtimi e do shumë kafshën e tij përkëdhelëse. Ai kujdeset për të.



- Në çfarë mënyrash kujdesesh për anëtarët më të vjetër dhe më të rinj të familjes?
- Si kujdesesh për kafshën tënde përkëdhelëse?
- Numëro disa shembuj përmes të cilëve tregon se je fëmijë i kujdesshëm.

3. Marku dhe Maria janë binjakë. Marku gjithmonë zemërohet kur Maria pas mësimit e lë dhomën të parregulluar. Librat janë në dysHEME, shtrati nuk është i rregulluar dhe lodrat janë të shpërndara në të gjithë dhomën. Për dallim nga ajo, tavolina e Markos është e rregulluar dhe rrobat në dollapin e tij janë rregulluar mirë. Marko është fëmijë i **aftë** dhe kujdeset për higjienën në shtëpi.

- Çfarë duhet të bëjë Maria për ta mbajtur dhomën e saj të rregulluar?
- Në çfarë mënyre tregon se je fëmijë i aftë?
- Pse duhet të jesh i aftë?
- Numëro disa mënyra në të cilat mund të kontribuosh në rregullimin e shtëpisë.



4. Babai i Fatimes është në kopsht duke mbjellë lule. Fatimja është me të dhe e ndihmon: ajo i ujit lulet që i mbjell babai i saj.

- Ti je fëmijë i **aftë** – i tha i ati.

Nëna e saj i thirri për të ngrënë drekë. Fatimja hyri në shtëpi dhe e ndihmoi të shtronte drekën në tavolinë.

- Ti je fëmijë i aftë – i tha nëna.

Pas drekës Fatimja lexoi leximin që e kishte për detyrë shtëpie.

- Ti je fëmijë i aftë – i tha gjyshja.

- Çfarë do të thotë të jesh i aftë?
- Si e tregon se je i aftë?
- Pse duhet të jesh i aftë?
- Numëro disa shembuj përmes të cilëve do të vërtetosh se je fëmijë i aftë.



- Fëmijët dhe të rriturit kujdesen së bashku për shtëpinë. Të jesh i përgjegjshëm, i zellshëm, i kujdesshëm dhe i aftë do të thotë që
- kujdesesh për anëtarët e shtëpisë dhe familjes. Kështu, midis
- vete tregoni se respektoheni dhe e duheni.

DETYRË

Plotësoji thëniet me fjalët e duhura nga banka e fjalëve:

1. Vëllai im i madh rregullisht blen bukë për fqinjin tonë të sëmurë.

Ai për të.

2. Jaglika gjithmonë është e kujdesshme për të përzgjedhur mbeturinat nga shtëpia.

Ajo është

3. Motra ime gjithmonë i ndihmon prindërit e mi.

Ajo është

4. Krevati dhe dollapi im janë gjithmonë të rregulluara.

Unë jam fëmijë.....



BANKA E FJALËVE:

përgjegjëse

kujdeset

i aftë

e vyeshme




MBROJTJA NGA FATKEQËSITË ELEMENTARE

ZJARRI

KUJTOHU:



Pse duhet të kesh kujdes kur përdor pajisje elektrike në shtëpi?



MENDO DHE PËRGJIGJU



1. Shiko ilustrimet dhe shpjego cilat do të jenë pasojat:



2. Numëro shembuj të tjerë që mund të jenë arsye për shkaktimin e zjarrit në shtëpi.



Si të mbrohesh gjatë zjarrit?

- Nëse vëreni zjarr, menjëherë thirr ndonjë nga të rriturit (prindërit, fqinjët ose dikë që kalon pranë shtëpisë sate).
- Thirri zjarrfikësit në numrin e telefonit 193 ose 112. Mos harro të tregosh adresën ku jeton.
- Largohu menjëherë nga zjarri sa më shpejt dhe sa më shumë që të jetë e mundur.
- Mos e shuaj zjarrin me ujë nëse është shkaktuar nga ndonjë pajisje elektrike.



A E DI SE:

Ndonjëherë zjarr mund të shkaktohet edhe nga xhami që lihet pa kujdes në natyrë. Kjo ndodh nëse ekspozohet një kohë të gjatë në rrezet e diellit dhe pranë tij ka objekte që janë lehtësisht të ndezshme.

MBAJ MEND!

MOS LUANI ME ZJARRIN.



- Zjarri mund të ndodhë në shtëpi, por edhe në mjedisin tuaj të afërt. Trajtimi jo i duhur i pajisjeve elektrike, përdorimi i pakujdesshëm i zjarrit, loja me substanca të ndezshme mund të shkaktojnë zjarr. Pakujdesia njerëzore është shkaku më i zakonshëm i zjarrit.



PËRMBYTJA




KUJTOHU:

Pse pas çdo përdorimi duhet të kontrollosh se a është çezma e mbyllur?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Shikoji ilustrimet dhe shpjego shkaqet e përmbytjeve në shtëpi:



2. Numëro edhe shembuj të tjerë të cilët mund të jenë shkaktarë të përmbytjeve në shtëpi ose natyrë.

.....

.....

.....

.....

.....





Si të mbrohesh gjatë përmbytjes?

- Nëse vëren se përmbytja është shkaktuar nga çezma e hapur, mbylle menjëherë.
- Nëse vëren se ka përmbytje në shtëpi për të cilën nuk e di arsyen, menjëherë thirrë dikë më të moshuar ose telefono në numrin 112. Prej atje do të dërgojnë ndihmë.
- Mos iu afro burimit të energjisë elektrike dhe mos ndiz aparat elektrik.
- Mbajni këpucët në këmbë, mos shkel në ujë këmbëzbathur.
- Mos përdor ushqime që kanë qenë në kontakt me ujin e përmbytjes.
- Nëse vlerëson se niveli i ujit po rritet, largohu nga vendi i përmbytjes, mundësisht në vendi më të lartë.



MBAJ MEND!

KONTROLLO GJITHMONË SE A E KE MBYLLUR ÇEZMËN PAS PËRDORIMIT.

- Përmbytja është fatkeqësi elementare. Mund të ndodhë në natyrë,
- por edhe në shtëpinë tënde. Shkaku më i zakonshëm i
- përmbytjeve në shtëpi është plasja e gypit të ujit dhe lënia e
- çezmës së hapur. Pra, bëhu i përgjegjshëm kur e përdor ujin e
- çezmës.



TËRMETI



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. A ke ndjerë ndonjëherë tërmet?
2. Çfarë ndodh gjatë tërmetit?
3. Si u ndjeve atëherë?
4. A di si të mbrohesh gjatë tërmetit?



- Tërmeti është fatkeqësi elementare që ndodh në natyrë, por pasojat i ndjen njeriu. Tërmetet nuk mund të parandalohen, por ka udhëzime për mbrojtjen nga tërmetet.



Si të mbrohesh gjatë tërmetit?

- Kur ndjen tërmet, mos u frikëso.
- Nëse ke mundësi, dil nga shtëpia dhe kërko daljen më të afërt për të dalë.
- Asnjëherë mos e përdor ashensorin për të ikur më shpejt.
- Derisa tërmeti zgjat, largohu prej dritareve, objekteve prej xhami dhe burimeve të energjisë elektrike.
- Kërko strehim në shtëpi që do të të mbrojë, për shembull tavolinë të fortë, mur mbajtës në banesë/shtëpi. Në të njëjtën kohë gjunjëzohu dhe mbroje kokën me duar.
- Nëse je në hapësirë të hapur, qëndro larg ndërtesave, shtëpive më të larta dhe kabllave elektrike në shtylla.





DETYRË

1. Nën ilustrimet shkruaj se cilën fatkeqësi elementare e njohë:



2. Përshkruaj çfarë duhet të bësh gjatë:

- a) përmbytjes
- b) zjarrit
- c) tërmetit



3. Një ditë nxënësi i klasës së dytë Miri shikoi kah oborri i fqinjit të tij Burhanit. Vuri re se uji rridhte poshtë murit të shtëpisë së tij. Çfarë duhet të bëjë Miri në atë rast? (shkruaj ose vizato në vendin e zbrazët):



TEMA 3 VENDBANIMI



TEMA 3: VENDBANIMI



VENDBANIMI:

- Qyteti/fshati
- Objektet në qytet



JETA NË FSHAT DHE JETA NË QYTET:

- Nga ara në tryezë
- Fshat apo qytet?



TRAFIKU NË VENDBANIM:

- Unë si këmbësor
- Unë si çiklist
- Si sillem në autobus?





Unë jetoj në (qytetin/fshatin)
 por kam një shok i cili jeton në (qytetin/fshatin)

.....

E dua vendin tim të jetesës sepse:

.....




VENDBANIMI

Qyteti/fshati

KUJTOHU:

Si duket qyteti dhe si duket fshati? Emërto një qytet/fshat që ke vizituar.



MENDO DHE PËRGJIGJU


1. Shikoji ilustrimet, dallo cili ilustrim e tregon fshatin dhe cili qytetin dhe shpjego sipas çkahut i njohe?



2. Kush zë sipërfaqe më të madhe: qyteti apo fshati?



3. Sipas ilustrimit vlerëso ku ka më shumë banorë: në fshat apo qytet?



Fshati është vendbanim më i vogël. Ai zë sipërfaqe më të vogël dhe ka më pak banorë.

Qyteti është vendbanim më i madh. Qyteti zë sipërfaqe më të madhe dhe ka më shumë banorë se fshati.

4. Shiko ilustrimet dhe numëroji ndryshimet midis vendbanimeve në fshat dhe vendbanimeve në qytet:



5. Cilat objekte i ke njohur në ilustrimin me fshat? Për çfarë shërbejnë ato?

6. Cilat objekte i ke njohur në ilustrimin me qytet? Për çfarë shërbejnë ato?

7. Përshkruaje oborrin e fshatit.

8. Përshkruaje lagjen e qytetit.

Shtëpitë në fshatra kanë oborre të veta, disa prej tyre kanë stallë, magazinë, kopsht dhe pemishte. Shumica e familjeve fshatare rritin kafshë shtëpiake dhe shpezë.


Disa fshatra zhvillohen gjithnjë e më shumë dhe i ngjajnë mjedisit qytetar. Ata kanë rrugë të mirëmbajtura, parqe, shkolla dhe objekte të tjera që ua lehtësojnë jetën banorëve.

Në qytet njerëzit jetojnë në ndërtesa ose shtëpi. Në ndërtesa ka banesa dhe çdo ndërtesë ka oborr të përbashkët. Disa banesa kanë objekte ndihmëse si garazhe dhe bodrume.




DETYRË

Në ilustrimin e mëposhtëm në fushat e zbrazët shkruaj atë që dallon:



OBJEKTET NË QYTET




KUJTOHU:

Për cilin vendbanim themi se është qytet?
Numëro disa objekte të rëndësishme që ke parë në qytet?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Shiko ilustrimin dhe numëro cilat objekte janë atje dhe cilat nuk janë në qytetin tënd ose në qytetin më të afërt me vendbanimin tënd:



2. Për çka shërben secili prej objekteve/institucioneve që i numërove?
3. Cilat nga objektet e vërejtura gjenden në fshat?
4. Emërtoni profesionet e punonjësve që punojnë në këto institucione dhe objekte.
5. Si duhet të sillesh kur hyn në ndonjë institucion?

Institucionet me të cilat karakterizohen qytetet janë: spitali, stacioni i policisë, stacioni zjarrfikës, qendra tregtare, banka, muzeu, teatri, biblioteka e qytetit. Shërbimet e tyre përdoren nga njerëzit për qëllime të ndryshme.



DETYRË



Plotëso ku duhet të shkojnë ose të drejtohen shokët e tu:

Adnani dëshiron të blejë atlete. Ai duhet të shkojë me prindërit e tij në _____.

Sofia dëshiron të huazojë një libër. Për këtë ajo duhet të shkojë në _____.

Sanelës i dhemb fyti. Prindërit e saj e çuan në _____.

Martini vuri re se diçka po digjet në pyllin aty pranë. Për këtë duhet ta informojë _____.

Jane dhe Muzaferi duan të shohin një shfaqje teatrale. Prandaj janë marrë vesh të shkonin në _____.

Arsimtarja u tha nxënësve të klasës së dytë se do të vizitojnë vendi ku mund të mësojnë diçka më shumë për të kaluarën e vendbanimit të tyre. Ata do të shkojnë në _____.



AKTIVIZOHU:

Mblidhni fotografi të qytetit tënd ose qytetit më të afërt me vendin tuaj të jetesës. Zgjidhni fotografi që tregojnë spital, stacion policie, zjarrfikës, qendër tregtare, bankë, teatër, muze, bibliotekë të qytetit. Ndahuni në grupe dhe me ndihmë të kutive të kartonit bëni modelet e tyre të zvogëluara. Pasi secili grup do t'i bëjë modelet, vendosni ato së bashku si një tërësi. Diskutoni se çfarë tjetër i duhet qytetit për ta bërë atë më të bukur.

JETA NË FSHAT DHE JETA NË QYTET

Nga fusha në tryezë

KUJTOHU:

Nga se bëhet buka?
Nëse ke parë ndonjëherë se si bëhet buka,
përshkruaje procedurën.



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Lexo tekstin dhe përshkruaj procedurën e bërjes së bukës.

Mersiha jeton në qytet. Për mëngjes më së shumti i pëlqen të hajë kiflet dhe qumësht, por jo gjithmonë mund ta hajë tërë kiflet. Kur gjyshja e vëren se Mersiha ka lënë një copë kiflet, i thotë:

– Mersiha, vlerësoje mundin e bujkut, mos e lër copën e kifles.

Mersiha pyet veten se çfarë i thotë gjyshja e saj:

– Gjyshe, për çfarë bujku e ke fjalën kur i blejmë kiflet nga dyqani.

Më pas gjyshja i tregoi historinë e rrugës së bukës: **Nga kokrra deri në bukë.**

Mersiha, vlerësoje mundin e bujkut, mos e lër copën e kifles.

Gjyshe, për çfarë bujku e ke fjalën kur i blejmë kiflet nga dyqani.



Gruri rritet
dhe piqet.

Bujku e lëron
arën dhe e mbjell
grurin.

I ndan kokrrat nga
gruri.

Gruri dërgohet në
mulli ku bluhet dhe
përfitohet mielli.

Mielli dërgohet në dyqane ose fabrika
për të bërë bukë dhe pasta të bardha.
Prej këtu blejmë produkt të
përfunduar: bukë ose pasta të bardha.

Bujku e korr
grurin e pjekur.





MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Nga vjen qumështi në paketimin e kutisë që ti e pin?
2. Kush i rrit kafshët shtëpiake?
3. Shiko ilustrimin dhe përshkruaje rrugën e qumështit nga ferma në tryezën tuaj:



Njerëzit në fshatra merren kryesisht me **blegtori** dhe **bujqësi**.

Blegtoria është rritja e kafshëve shtëpiake dhe shpezëve si lopët, delet, derrat, pulat nga të cilat merret mishi, qumështi, leshi, vezët.

Bujqësia është kultivimi i pemëve, perimeve dhe drithërave. Njeriu i ato përdor për ushqim, por edhe për të ushqyer kafshët shtëpiake.

Njerëzit në qytete janë të angazhuar kryesisht në **industri** dhe **tregti**.

Me ndihmën e industrisë prodhohen dhe përpunohen produkte të ndryshme në fabrika: mobilje, makina, ushqime, ilaçe, materiale ndërtimi, veshmbathje dhe gjithçka tjetër që u nevojitet njerëzve.

Tregtia është shitja dhe blerja e gjithçkaje që prodhohet në blegtori, bujqësi dhe industri.



DETYRË

1. Lidhi ilustrimet me termat përkatës:

Blegtoria

Bujqësia

Industria

Tregtia



FSHAT APO QYTET?



KUJTOHU:

Me çka dallohet qyteti, kurse me çka dallohet fshati?
Përkujtohu kur herën e fundit ke qenë në qytet/fshat.
Çfarë të pëlqeu atje?



MENDO DHE PËRGJIGJU

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjeve:

Xhani jeton në fshat, kurse Jovani në qytet. Ata janë shokë. Shpesh Jovani shkon në fshat për të vizituar Xhanin, kurse Xhani shkon në qytet për të vizituar Jovanin. Jovani është i kënaqur nga numri i madh i kafshëve shtëpiake, duke përfshirë edhe qenin Baks. Gjëja më e mirë për të është kur gjyshja e Xhanit nga furra me dru do ta nxjerrë bukën e sapopjekur. Pastaj së bashku me Xhanin ulen për të ngrënë e për të pirë nga qumështi i sapo mjelur dhe i zier.

- Është bukur këtu në fshat – thotë Jovani.
- Po, është bukur, por është bukur edhe në qytet – thotë Xhani. – Më pëlqen fakti se në qytetin tënd ke shumë dyqane, qendra tregtare, ndërtesa të larta, shumë njerëz – të njohur dhe të panjohur, kurse në qytetin tënd ke edhe klub shahu, në të cilin unë dua të luaj. Gjithashtu keni teatër dhe pishinë. Por gjëja më interesante për mua është kur vij në shtëpinë tënde dhe ngjitem me ashensor në katin e nëntë. Kur dalim në tarracë dhe i shohim njerëzit nga lart, më duken si milingona.
- Jo jo. Më bukur është në fshat – thotë Jovani. – Në fshat mund të ecësh në natyrë dhe askush nuk kujdeset për ty nëse zbaton rregullat për këmbësorë, nëse kalon rrugën drejt sepse këtu nuk ke kryqëzime të mëdha dhe trafik të rënduar. Këtu është qetë dhe rehat. Ajri është i pastër, kurse pylli është afër, ku mund të ecësh dhe të shohësh shumë kafshë të egra.
- Mos u grindni – i thotë gjyshja e Xhanit. – Kudo është mirë për të jetuar, si fshati ashtu edhe qyteti kanë përparësitë e tyre.



1. Pse Jovani dëshiron të jetojë në fshat, kurse Xhani dëshiron të jetojë në qytet?
2. Cilat janë përparësitë e të jetuarit në fshat?
3. Cilat janë përparësitë e të jetuarit në qytet?
4. Ku do të dëshiroje të jetosh ti? Pse mu atje dëshiron të jetosh?




DETYRË

Në diagramin e Venit shkruaji përparësitë e të jetuarit në qytet/fshat. Në prerje shkruaj përparësitë e përbashkëta:

FSHATI

QYTETI



AKTIVIZOHU:

Ndani në dy grupe. Njëri grup le të japë shembuj për përparësitë e të jetuarit në qytet, kurse grupi tjetër për përparësitë e të jetuarit në fshat. Debatoni se ku është më mirë të jetohet. Në fund nxirrni përfundim.

TRAFIKU NË VENDBANIM

Unë si këmbësor


KUJTOHU:

Çfarë do të thotë fjala këmbësor?
Numëro disa rregulla trafiku për këmbësorët që i di.



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Shiko ilustrimin dhe shpjego kuptimin e termave të përmendur të trafikut:



2. Ku duhet të lëvizin këmbësorët?
3. Në cilin vend lejohet të kalosh rrugën?
4. Çfarë duhet të bësh përpara se të kalosh rrugën?
5. Ngjyrose dritën e nevojshme në semafor për të kaluar rrugën:



6. Shëno me ✓ cila nga shenjat e mëposhtme të trafikut tregon KALIM TË SHËNUAR TË KËMBËSORËVE:



7. Krahasoje trafikun në qytet me trafikun në fshat sipas ilustrimeve të dhëna dhe numëroji dallimet:



Trafiku zhvillohet në rrugë. Përgjatë rrugëve gjenden trotuare për të ecur këmbësorë. Ata kalojnë rrugën në vendkalimin për këmbësorë. Bulevardet janë rrugë të gjera dhe të gjata nëpër të cilat lëvizin automjetet. Udhëkryqi është vendi ku kryqëzohen dy ose më shumë rrugë. Në rrugë janë vendosur shenjat e trafikut dhe semaforët. Këmbësorët dhe shoferët duhet të respektojnë shenjat e trafikut dhe sinjalet e semaforit.

Ti je pjesëmarrës në trafik. Në të merr pjesë si këmbësor, çiklist ose udhëtar.

Për të qenë i sigurt në trafik duhet të respektohesh disa rregulla:



- Lëviz nëpër trotuar.
- Kalo rrugën vetëm në vendkalimin e këmbësorëve pasi semafori i këmbësorëve të jep sinjalin e dritës së gjelbër.
- Rruga nuk është vend për të luajtur.

Respektoni të TRE rregullat kryesore për kalimin e rrugës:


NDALO dhe mendo ku do të kalosh rrugën.



SHIKO së pari majtas, pastaj djathtas për të kontrolluar a vjen ndonjë automjet.



DËGJO a vjen ndonjë automjet.



KALO RRUGËN nëse sheh dhe dëgjon ndonjë automjet që afrohet.



A E DI SE:




Në disa vendbanime më të vogla nuk ka semaforë, vendkalime për këmbësorë dhe trotuare, prandaj njerëzit detyrohen të lëvizin përgjatë rrugës. Për siguri më të madhe në vende të tilla njerëzit duhet të lëvizin nga ana e majtë e rrugës. Kjo është kështu që ata të mund të shohin automjetin që afrohet. Nëse janë më shumë njerëz, ata duhet të lëvizin në kolonë njëri pas tjetrit. Nëse lëvizin natën, atëherë i pari dhe i fundit i kolonës duhet të ketë llamba, në mënyrë që drejtuesit e automjeteve të mund të shohin kolonën e këmbësorëve.

Në shumë qytete ka semaforë për personat me shikim të dëmtuar. Ato japin sinjal zëri kur rruga është e sigurt për t'u kaluar.



DETYRË

Në ilustrimin e mëposhtëm shëno me shigjetë se ku lejohet të lëvizësh si këmbësor dhe ku lejohet të kalosh rrugën: (ki kujdes në semaforët për këmbësorë).



UNË SI ÇIKLIST



KUJTOHU:

Si quhet shtegu në të cilin lëvizin biçikletat?
Kush guxon të lëvizë nëpër atë shteg?



MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Shiko ilustrimin dhe thuaj si quhen vendet nëpër të cilat lëviz automobili, këmbësori dhe çiklisti.



2. Për çfarë shërben shtegu i biçikletave?
3. Çfarë rregullash di për çiklistët?

4. Shëno me ✓ kcila nga shenjat e mëposhtme të trafikut tregon
SHTEGUN PËR BIÇIKLETA:



4. Shënoni me ✓ cila nga shenjat e mëposhtme të trafikut tregon
NDALIMI I TRAFIKUT PËR BIÇIKLETA:



RREGULLA PËR ÇIKLISTË:

Para se të ngasësh biçikletë,
gjithmonë kontrollo a është në
rregull. Kontrollo frenat, gomat,
dritat dhe zilen.



Gjithmonë kur nget
biçikletë mbaj kacigë për
kokë.



RREGULLA PËR ÇIKLISTË:

Biçikletën ngaje vetë. Mos hip persona të tjerë. Vetëm të rriturit lejohen ta bëjnë këtë.



Kur nget biçikletë, lëviz përgjatë korsisë për biçikleta. Në shtegun për biçikletë lëviz në anën e djathtë.



Gjithmonë jepi përparësi këmbësorëve.



Kur dëshironi të ktheheni majtas, zgjate dorën e majtë. Kur dëshironi të ktheheni djathtas, zgjate dorën e djathtë.





MENDO DHE PËRGJIGJU

1. Cilat mund të jenë pasojat nëse biçikleta që e nget ka frena me defekt?
2. Çfarë mund të ndodhë nëse NUK mban kacigë në kokë gjatë ngasjes së biçikletës?
3. Çfarë mund të ndodhë nëse në biçikletë është hipur shoku yt?




AKTIVIZOHU:

Krijoni model të udhëkryqit me shenja trafiku, semafor, trotuar, shteg biçikletash dhe vendkalim të shënuar. Ndahuni në dy grupe. Njëri grup le të jenë këmbësorë, kurse grupi i dytë çiklistë. Stimuloni dhe ushtroni lëvizjen e këmbësorëve dhe çiklistëve në rrugë dhe në udhëkryq.



SI SILLEM NË AUTOBUS



MENDO DHE PËRGJIGJU

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjeve:

Martini dhe Valbona janë shokë. Ata kanë udhëtuar me prindërit e tyre me autobus deri në Shkup. Kur hipën në autobus, disa udhëtarë janë shtyrë dhe donin të hipnin më shpejt në autobus. Martini dhe Valbona nuk ndiheshin të qetë derisa ata shtyheshin për të gjetur karrige të lirë. Pasi u ulën, hyri një plakë e mbështetur në një bastun. Valbona e kuptoi se duhet t'i linte vendin të moshuarve. U ngrit nga karrigia dhe tha:

– Urdhëroni, uluni në këtë vend.

Gruaja e falënderoi dhe u ul në karrigen e liruar.

Nëna e saj e shikoi me krenari dhe buzëqeshi.



1. Cilat veprime të padrejta të udhëtarëve i ke vërejtur?
2. Cilat veprime të drejta i ke vërejtur?
3. Si duhet të veprosh kur hip në autobus?

RREGULLAT E SJELLJES NË AUTOBUS:

Gjatë hyrjes në autobus duhet t'i kushtosh vëmendje rendit të hyrjes. Përparësi u jepet personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve.



Liroja karrigen tënde të moshuarve, të sëmurëve dhe të pafuqishmëve.



Në autobus fol qetë në mënyrë që të mos shqetësosh udhëtarët e tjerë.



Mos u nge nga karrigia pa arsye dhe mos e pengo shoferin.



RREGULLAT E SJELLJES NË AUTOBUS:

Gjatë daljes nga autobusi së pari lejo të dalin të moshuarit, të sëmurët dhe personat e pafuqishëm.



MBATJ MEND: Kur del nga autobusi mos e kalo rrugën nga pjesa e përparme e autobusit. Gjithmonë ndalu, prit që të shkojë autobusi, shiko në fillim majtas pastaj djathtas dhe nëse nuk ka automjete kaloje rrugën sigurt.





DETYRË

Me shenjë  shëno se cila sjellje në autobus është e drejtë, me shenjë  shëno sjelljen që nuk është e drejtë dhe shpjego pse u përgjigje kështu:



SHKRUAJ ÇFARË TË PËLQEU MË SHUMË NGA
PËRMBAJTJET QË I MËSOVE NGA LËNDA E
SHOQËRISË



SHIHEMI NË KLASËN E TRETË



